



Klonimi – Plani i orës

Detyrat e nxënësve

- Të kuptohet roli i marrjes së vendimeve në mënyrë demokratike gjatë respektimit të dinjitetit dhe lirisë së mendimit në fushën e shkencës, mjekësisë dhe shëndetin publik.
- Të mësohet për çështjet që i tërheq klonimi gjenetik i termave të shkencës dhe politikës publike që shfrytëzohen për diskutimet e kësaj fushe shkencore.
- Të gjurmohen tensionet ndërmjet mbrojtjes së dinjitetit të njeriut dhe zvogëlimit të vuajtjeve të njeriut që trajtohen në diskutimin e klonimit terapeutik të qelizave të njeriut.
- Të analizohen shkaqet e mbështetjes ose kundërshtimit të klonimit terapeutik të qelizave njerëzore.
- Të gjenden fushat e pajtueshmërisë dhe papajtueshmërisë me nxënësit e tjerë.
- Të merret vendim, individual ose grupor, se a duhet të lejojë pushteti klonim terapeutik të qelizave të njeriut; të mbështeten vendimet në bazë të dëshmive dhe të menduarit të shëndoshë.
- Të mendohet në lidhje me vlerën e diskutimit të argumentuar kur merren vendime për çështje të ndryshme në një demokraci.

Çështje për diskutim të argumentuar

A duhet të lejojë demokracia jonë klonim terapeutik të qelizave të njeriut?

Materialet

- Procedura e orës
- Materiali nr. 1— Udhëzues për diskutime të argumentuara
- Materiali nr. 2— Përshkrim i shkurtër i diskutimit të argumentuar
- Materiali nr. 3—Qasja e nxënësve ndaj diskutimit të argumentuar
- Copë leximi
- Burimet e zgjedhura
- Copë leximi plotësuese për arsimtarin
- Çështje për diskutim të argumentuar me argumente të parashtruara
(*me zgjedhje – përdoren nëse nxënësit e kanë vështirë t'i nxjerrin argumentet ose nëse koha është e kufizuar*)



Klonimi – Copë leximi

1 Në vitin 1996 shkencëtarët e krijuan në Skoci delen Doli, që ishte një kopje identike
2 origjinale me nënën e saj. Që atëherë e këndej edhe shkencëtarët e pjesëve të tjera të botës kanë
3 krijuar dublikate gjenetike nga kafshët, si nga lopa, miu, macja, qeni, kali, derri, madje edhe nga
4 dhelpra. Ky proces, që njihet si *klonim*, ka bërë që të rritet interesi dhe brenga e autoriteteve dhe
5 njerëzve të zakonshëm. Zyrtarët dhe qytetarët gjithandej nëpër botë kanë diskutuar në lidhje me
6 përdorimin qelizave njerëzore në hulumtimin mjekësor dhe për mundësinë e shumimit të
7 njerëzve përmes klonimit.

8 **Llojet e klonimit**

9 Klonimi është një formë tjetër e shumimit të ndihmuar, siç janë edhe fekondimi artificial dhe
10 fekondimi *in vitro*. Gjatë shumimit të ndihmuar bashkohet spermatozoidi i dhuruesit – mashkull
11 dhe qeliza vezë e dhurueses – femër, si në shumimin natyror. Ndërkaq klonimi përfshin përcjellje
12 të materialit gjenetik nga bërthama e një qelize të rritur të një organizmi dhe futja e saj në qelizën
13 vezë, të cilat materialit gjenetik më parë është mënjanuar. Pasi të pranojë dozë të baraspeshuar e
14 me kujdes të energjisë elektrike, qeliza vezë fillon të ndahet në embrion njësoj si të jetë
15 fekonduar me spermatozoid.

16 Në lidhje me klonimin e njeriut shkencëtarët dhe, në përgjithësi, përgjegjësit e krijimit të
17 politikave bëjnë dallim ndërmjet *klonimit terapeutik dhe reprodaktiv (shumues)*. Edhe pse në
18 fazat fillestare në të dyja proceset përdoren teknikat e njëjta (Këshilli Nacional Gjerman i Etikës,

19 2004), ato shumë shpejt u bënë mënyra të rëndësishme (Komiteti për Shkencë, Inxhinieri dhe
20 Politika Publike, 2002)

21 **Klonimi reprodaktiv**, proces që përdorej për t'u krijuar delja Doli, përfshin implantim
22 (mbjellje) të embrionit në mitrën e një femre. Nëse kjo mbjellje është e suksesshme, embrioni
23 rritet dhe lind njësoj si secila foshnje. Rezultati, si “Mini-unë” i Dr. Ligut në filmat *Ostin*
24 *Pauers*¹ ose mjeshtrit kompozitorë të operës ruse *Fëmijët e Rozentalit*,² është kopje gjenetike e
25 dhuruesit

26 **Klonim terapeutik** nuk mbjell embrion në mitrën e organizmit të femrës. Në vend të kësaj,
27 klonimi terapeutik përqendrohet në qelizat stem dhe në atë sesi të zhvillohen ato. Këto qeliza
28 vërtet mund të përdoren për shumë qëllime: të gjitha qelizat e specializuara në trup – eshtra, gjak,
29 nerva, muskuj, lëkurë – zhvillohen nga qelizat stem. Edhe përkundër mundësisë së tyre që të
30 përdoren për shumë qëllime, qelizat stem “vetë nuk mund të krijojnë fetus të tyre ose kafshë të re
31 (COSEPUP, 2002). Disa hulumtues e përdorin klonimin terapeutik që t'i kuptojnë të metat
32 gjenetike. Ata po ashtu e përdorin klonimin terapeutik edhe që të mësojnë sesi përtërihen qelizat
33 ose indet stem te personat që uftojnë me sëmundjet degjeneruese ose që janë të dëmtuar nga
34 lëndimet. Ndërkaq shkencëtarë të tjerë punojnë në klonim terapeutik, sepse besojnë se hulumtimi
35 i qelizave stem, si dhe i kufijve të tjerë në shkencë, do të krijojë zbulime të papritura.

36 **Burimet e qelizave për klonim**

37 Në këtë moment teprica e embrioneve të dhuruara nga prindërit që bëjnë fekondim *in vitro*
38 përdoret si burim i qelizave stem. Klinikat e fekondimit i hedhin si të papërdorura këto embrione.
39 Në rastet kur hulumtuesit pranojnë embrione nga laboratorit, ato janë vetëm disa qeliza të vjetra,

40 por janë të gjalla dhe rriten. Embrionet janë ende balstociste. Kjo do të thotë se ato janë toptha të
41 zbrazët me 64 deri në 200 qeliza në dy shtresa. Hulumtuesit i mënjanojnë qelizat stem – shtresën
42 e brendshme të qelizave – që ato t’i rrisin në laborator. Shtresa e jashtme – që do të zhvillohej në
43 placentë, një mbështjellës përmes të cilit materiet ushqyese përcillen deri në fetusin që rritet –
44 hidhet.

45 **Debati në lidhje me klonimin**

46 Asnjë vend në botë nuk e mbështet klonimin reprodaktiv të njerëzve. Që nga krijimi i deles
47 Doli, disa vende të caktuara dhe bashkësia ndërkombëtare përpiqeshin ta ndalojnë klonimin me
48 qëllim që kështu të krijojnë trashëgimi. Deklarata e Asamblesë së Përgjithshme e vitit 1998 thotë
49 se “Praktikat që janë në kundërshtim me dinjitetin e njeriut, siç është klonimi reprodaktiv i
50 qenieve njerëzore, nuk do të lejohet” (Deklarata Universale e Gjenomit të Njeriut dhe të Drejtave
51 të Njeriut).

52 Megjithatë Deklarata po ashtu thekson se “Liria e hulumtimit, e cila është e nevojshme për
53 përparimin e diturisë, është pjesë e lirisë së të menduarit. Zbatimet e hulumtimeve, përfshirë
54 edhe zbatimet në lidhje me gjenomin e njeriut në biologji, gjenetikë dhe medicinë, do të kërkojnë
55 ndihmë për shpëtim nga vuajtja dhe përmirësimi i shëndetit të individëve dhe i njerëzimit në
56 tërësi” (neni 12). Kjo baraspeshë e interesave – ruajtja e dinjitetit dhe shpëtimit nga vuajtjes e
57 njeriut – e parashtron linjën themelore që i ndan ata që në klonimin terapeutik shohim premtimin
58 dhe vlerën e klonimit terapeutik dhe ata që kërkojnë ndalim të plotë të të gjitha llojeve të
59 klonimit.

60 **Klonimi në shoqërinë demokratike: Kush vendos?**

¹ “Mini-Me”; Dr. Evil; Austin Powers

61 Një çështje tjetër themelore në diskutimin për klonimin është se kush ka autoritet të vendosë.
62 Shumë vende kanë krijuar komitete këshilluese nga shkencëtarë, eticienë dhe ekspertë të
63 mjekësisë që t'u ndihmojnë ta kuptojnë klonimin. Megjithatë shumë qeveri e mbajnë fuqinë të
64 vendosin vetë. Nuk është për t'u habitur fakti që demokraci të ndryshme kanë bërë zgjedhje të
65 ndryshme. Për shembull, Këshilli Nacional Gjerman i Etikës në vitin 2004 rekomandoi që vendi
66 ta ruajë ligjin e tij të vitit 1990 për mbrojtjen e embrioneve. Ky ligj i ndalon të gjitha format e
67 klonimit. Ky vendim ishte marrë edhe pse shumica e anëtarëve të Këshillit ishin të mendimit që
68 hulumtimi terapeutik të lejohet. Në vitin 2006 Kuvendi i Australisë e tërhoqi ndalesën e klonimit
69 terapeutik, ndërsa ndalesa pesëvjeçare në Rusi u desh të shqyrtohet përsëri në vitin 2007. Që nga
70 vitit 2001 Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kufizuan sponsorizimin federal të klonimit
71 terapeutik, me çka hulumtimi u kufizua në fushën e vogël të miratuar nga Qeveria, që i përfshin
72 qelizat stem. Megjithatë hulumtimet e sponsorizuara nga burime private dhe shtetërore
73 vazhdojnë në institute hulumtuese dhe në universitete në SHBA.

74 **Klonimi i qelizave të njeriut: mbështetësit dhe kundërshtuesit**

75 Mbështetësit e klonimit thonë se përdorimi i pakujdesshëm i termit *klonim* e ka shqetësuar
76 opinionin në llogari të shkencës së mirë. Klonimi reprodutiv e vendos një qelizë të ndryshuar
77 njerëzore në mitrën një individi femër. Në kundërshtim me këtë, klonimi terapeutik ndodhë në
78 laborator dhe nuk mund të rezultojë me krijimin e qenies njerëzore. Dallimet e qarta në teknikën
79 ndërmjet klonimit reprodutiv dhe konsensusit ndërkombëtar kundër klonimit reprodutiv
80 nënkuptojnë se ekziston një rrezik i vogël nga manipulimet prej klonimit që bëhet për shërim në
81 klonimin që në përgjithësi gjykohet.

² Rosenthal's Children

82 Mbështetësit thonë se teknologjia e klonimit patjetër duhet të rregullohet. Përmes masave
83 ligjore dhe mbrojtëse, shoqëria mund të përcaktojë se çfarë lloji i klonimit është i pranueshëm, e
84 çfarë jo. Klonimi reprodutiv mund të identifikojë, izolojë, kriminalizojë dhe, atëherë ka nevojë,
85 të dënojë pa u kufizuar klonimi teraupetik.

86 Edhe pse shfaqin brengosje në lidhje me eksperimentimin me njerëz, mbështetësit e klonimit
87 terapeutik theksojnë se “embrionet” që përdoren në hulumtime janë shumë blastociste nga qeliza
88 të paidentifikuara stem. Këto blastociste në klinikat e fekondimit dhe institucionet mjekësore do
89 të hidheshin ose do të zhdukeshin. Përmes klonimit terapeutik këto qeliza mund të ruhen dhe të
90 përdoren që të përparohet jeta e njeriut.

91 Mbështetësit pohojnë se klonimi terapeutik premtion shumë për zvogëlimin e vuajtjeve të njeriut
92 dhe përparimin e diturisë së njeriut. “Sigurimi i qelizave dhe indeve përmes klonimit terapeutik
93 jep shpresë të madhe për shumë pacientë me sëmundje të pashërueshme”, thotë profesoresha Eva
94 Siklova³, drejtoreshë e Institutit të Medicinës Eksperimentale në Akademinë e Shkencave në
95 Pragë. Hulumtimit do t’i prijë arsyeja dhe principet demokratike: rezultatet do të jenë objekt i
96 shqyrtimit shkencor nga kolegët, ndërsa puna shkencore do të realizohet vetëm me dituri dhe leje
97 të shoqërisë.

98 Kundërshtarët e klonimit të njeriut thonë se proceset “e ndryshme” të klonimit reprodutiv
99 dhe terapeutik bazohen të dyja në shkatërrimin e embrioneve të njeriut. Në këtë mënyrë, thonë
100 ata, nuk ka kurrfarë dallimi moral mes tyre. Klonimi i mohon të drejtat themelore të njerëzve dhe
101 i thjeshtëson ato në komoditete teknike ose mjekësore. Siç thekson Okon Efiom Izong⁴ nga
102 misioni i OKB-së në Nigeri: “Kombet e Bashkuara ishin themeluar para së gjithash që t’i

³ Eva Syklovà

103 ndalojnë të gjitha aktet që mund ta rrënojnë shenjtërinë dhe dinjitetin jetës së njeriut – përfshirë
104 edhe zbatimin e ndihmës së shkencës dhe teknologjisë. Është paradoks i pakuptueshëm ajo që
105 mbështetësit e klonimit të njeriut për qëllime terapeutike do të përcaktoheshin ta zhdukin ose ta
106 viktimizojnë jetën e njeriut – sepse embrioni është jetë njeriu, qenie njerëzore në fazat e saj
107 formative – me qëllim që të shpëtohet jeta e një njeriu tjetër.”

108 Kundërshtarët po ashtu thonë se klonimi i njeriut u krijon trajtim më të mirë të gjallëve sesa
109 të palindurve, që nuk mund ta shprehin mendimin e tyre. Si të merret një embrion për klonim
110 terapeutik, ajo jetë përfundon. Përgjegjësia u mbetet atyre që mund të flasin që t’i përfaqësojnë
111 ata që nuk munden. Më tej, qelizat stem që janë të nevojshme për hulumtim mund të merren
112 edhe nga burime të tjera, si nga gjaku dhe kërthiza. Në këtë mënyrë përdorimi i embrioneve të
113 klonuara është krejt i panevojshëm.

114 Pastaj kritikët e tërheqin vërejtjen edhe për divergjencën ndërmjet çmimit të klonimit dhe dobitë
115 e tij të mundshme për njeriun. Cilëndo hapa shkencorë ose mjekësorë që mund të merren, ato janë
116 të larguara me decenie nga koha jonë, thonë ata. Ato përparime para së gjithash do t’u bëjnë dobi
117 të pasurve dhe të fuqishmëve. Të hollat dhe mundi shkencor që i kushtohet klonimit mund të
118 investohen më mirë në luftën kundër problemeve aktuale – siç janë SIDA, malaria dhe
119 tuberkulozi. Ajo qasje do t’u ndihmonte dhjetëra miliona njerëzve, prej të cilëve shumica janë të
120 varfër nga gjithë bota. Vendimet në lidhje me këto çështje nuk mund t’u lihen në dorë vetëm
121 shkencëtarëve, sepse ata dëshirojnë të bëjnë gjithçka mund të bëhet. Ata gjithnjë mendojnë për
122 atë që duhet të bëhet.

⁴ Okon Efion Isong



Klonimi – Burime të zgjedhura

„Ndalimi pesëvjeçar i klonimit të njeriut në Rusi”, “Lajme Prima [Prima News] (10 prill, 2002), <http://www.primanews.ru/eng/news/news/2002/4/10/9541.html?print>.

“Protokollo plotësues i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Dinjitetit të Njeriut në Raport me Zbatimin e Biologjisë dhe Mjekësisë, për Ndalesën e Klonimit të Qenieve Njerëzore”, (Paris: Këshilli i Evropës, i hapur më 12 janar, 1998, hyri në fuqi më 3 janar, 2001), <http://conventions.coe.int/Treaty/en/Treaties/Html/168.htm>.

“Komiteti *Ad Hoc* për Konventën Ndërkombëtare Kundër Klonimit Reproductiv të Qenieve Njerëzore”, (Nju-Jork: Kombet e Bashkuara), <http://www.un.org/law/cloning/>.

Birdsli, Tim [Beardsley, Tim], “Klonimi i lëkurës së qengjit”, Amerikani i Mësuar (3 mars, 1997), <http://www.sciam.com/article.cfm?articleID=0009B07D-BD40-1C59-B882809EC588ED9F>.

“Kliko dhe klono”, “Qendra për mësimin e gjenetikës”, Universiteti i Jutës, <http://learn.genetics.utah.edu/units/cloning/clickandclone/>.

“Klonimi i dokumenteve me fakte”, Programi i gjenomit të njeriut, Zyra e hulumtimit dhe gjurmimit biologjik të mjedisit, Zyra e shkencës, Ministria e Energjetikës së SHBA-ve. http://www.ornl.gov/sci/techresources/Human_Genome/elsi/cloning.shtml.

Komiteti i Shkencës, Inxhinierisë dhe Politikave (COSEPUP), Këshilli i Shkencave Jetësore (BLS), “Qasje ekzekutive”, *Aspektet mjekësore dhe shkencore të klonimit reproductiv të njeriut* (Uashington DC: Akademia Nazionale e Shkencave, 2002), www.nap.edu/openbook/0309076374/html/1.html.

Fondacioni i Drejtave Kushtetuese, “Gjurmimi i qelizave stem: Premtimet dhe rreziqet”, *Ligji i të drejtave në praktikë*, 22:4 (dimër, 2006).

“Rezoluta 56/93 e Asamblesë së Përgjithshme, Konventa Ndërkombëtare Kundër Klonimit Reproductiv të Qenieve Njerëzore” [pa vota], <http://www.un.org/Depts/dhl/resguide/r56.htm>.

Këshilli Nacional Gjerman për Etikë. *Klonimi për qëllime reproductive dhe klonimi për qëllime të hulumtimit, it biometrik: Mendim* (Berlin: 2004 Nationaler Ethikrat, 2004), http://www.ethikrat.org/english/publications/Opinion_Cloning.pdf.

Klonimi njerëzor dhe dinjiteti i njeriut: Çështje etike (Uashington DC: Këshilli Presidencial i Bioetikës, korrik 2002), <http://bioethics.gov/reports/cloningreport/index.html>

“Hulumtimi koreanojugor me klonim ishte gënjeshtër”, Lajme Bi-bi-si (23 dhjetor, 2005), <http://news.bbc.co.uk/1/hi/world/asia-pacific/4554422.stm>.

“Shkencëtarët ‘klonuan embrione të njeriut’”, CNN.com (12 shkurt, 2004), <http://www.cnn.com/2004/HEALTH/02/12/science.clone/>.

“Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Klonimin e Njeriut”, Rezoluta 59/280 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (23 mars, 2005),

<http://www.pre.ethics.gc.ca/english/pdf/UN%20Nations%20Resolution%202005.pdf>.

Stejt departamenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Byroja për marrëdhënie me opinionin, “Të ndalohej klonimi i njeriut” (16 shtator, 2004), <http://www.usunnewyork.usmission.gov/ga59-fact5.pdf>.

“Deklarata Universale e Gjenomit të Njeriut dhe të Drejtave të Njeriut”, Rezoluta 53/152 e Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (9 dhjetor, 1998), <http://www.ohchr.org/english/law/genome.htm>.



Klonimi – Çështje për diskutim të argumentuar me argumente të ofruara

Çështje për diskutim të argumentuar

A duhet të lejojë demokracia jonë klonim terapeutik të qelizave të njeriut?

PO – Argumente për mbështetjen e çështjes së diskutimit të argumentuar

1. Përdorimi preciz i termit *klonim* e shqetëson opinionin në llogari të shkencës së mirë. Klonimi terapeutik dhe reproduktiv janë shumë të ndryshëm. Klonimi reproduktiv e vendos qelizën e njeriut në mitrën e një femre. Në kundërshtim me këtë, klonimi terapeutik ndodhë në laborator dhe nuk mund të bëjë krijimin e qenies së njeriut. Këto dallime nënkuptojnë se ekziston një rrezik i vogël nga manipulimet prej klonimit që bëhet për shërim në klonimin që në përgjithësi gjykohet.
2. Klonimi terapeutik mbulon një diapazon të gjerë të mundësive shkencore. Aty bie hulumtimi i qelizave stem dhe llojeve të tjera të klonimit joreproduktiv. Klonimi terapeutik premton zvogëlimin e vuajtjeve të njeriut dhe përparimin e diturisë së njeriut.
3. Teknologjia e klonimit është një sprovë e madhe që të lihet e parregulluar. Për shkak të potencialit të saj të paparë, njerëz të pandërgjegjshëm do të përpiqeshin të bëjnë klonim. Përmes proceduarve ligjore dhe masave mbrojtëse, shoqëria mund të përcaktojë se cili klonim është i lejuar. Ajo po ashtu mund të vendosë kufij dhe të përcaktojë se cili lloj i klonimit është legal. Klonimi reproduktiv mund të identifikohet, të izolohet dhe, aty ku mundet, të dënohet pa vënë kufizim të diturisë shkencore ose të hapave të mjekësisë që mund të arrihen përmes klonimit terapeutik.
4. Shkencëtarët janë pajisur me trajnim të patjetërsueshëm teknik dhe bagazh shkencor që të mund të marrin vendime të informuara në lidhje me klonimin. Shoqëritë demokratike e kanë patjetër të mësohen të diskutojnë dhe të debatojnë në lidhje me çështjet morale dhe etike në lidhje me klonimin terapeutik. Ekspertiza e shkencëtarëve është e patjetërsueshme që t'u ndihmojë demokracive për të marrë vendime në lidhje me politikën.
5. “Embrionet” që përdoren gjatë hulumtimeve nuk janë bebe me duar, këmbë ose tru. Ajo janë toptha të vegjël të përbërë nga qeliza stem. Aq më tepër, që embrionet që tash përdoren vijnë nga klinikat e fekondimit, ku zakonisht embrionet e papërdorura hidhen. Duke i shfrytëzuar ato për hulumtim, krijohet siguria se ato nuk janë harxhuar kot. Shfrytëzimi i tyre e çmon potencialin e tyre jetësor që të përhapet dituria e njeriut.



Klonimi – Çështje për diskutim të argumentuar me argumente të ofruara

Çështje për diskutim të argumentuar

A duhet të lejojë demokracia jonë klonim terapeutik të qelizave të njeriut?

JO – Argumente për kundërshtimin e çështjes së diskutimit të argumentuar

1. Edhe procesi i klonimit terapeutik edhe procesi i klonimit reprodutiv e bëjnë një akt të përbashkët: shkatërrimin e embrioneve të njeriut. Kështu klonimi terapeutik nuk është i ndryshëm nga klonimi reprodutiv – një veprim të cilin bota zakonisht e dënon si sulm ndaj dinjitetit të njeriut.
2. Klonimi terapeutik është i keq për shkak se kërkon të krijojë qenie njerëzore vetëm që ata të mund “të mbillen” për përmirësimin e qenieve të tjera njerëzore. Ky aktivitet e krijoi përshtypjen se disa jetë njerëzore janë më të rëndësishme se disa të tjera. Ligjet ndërkombëtare më së shumti janë krijuar që t’i mbrojnë të gjitha qeniet njerëzore nga një gjykim i tillë. Më tej, embrionet e klonuara nuk janë të nevojshme për hulumtimin e qelizave stem – qelizat e gjakut dhe ato nga kërthiza mund të përdoren në vend të tyre.
3. Klonimi është shumë i shtrenjtë dhe secili përparim që do të ndodhë disa decenie më vonë, do t’u shërbejë vetëm të pasurve. Të hollat dhe mudi që i kushtohet klonimit duhet të shpenzohen në probleme aktuale – si: SIDA, malaria dhe tuberkulozi – që i kanë prekur miliona njerëz, zakonisht njerëz të varfër në gjithë botën.
4. Njerëzimi nuk mund ta lërë vendimin për klonimin e njeriut në dorë “të ekspertëve”. Shkencëtarët nuk pyesin se a duhet apo nuk duhet të bëhet diçka: në vend të kësaj ata pyesin se a mundet dhe çka mund të mësohet nga ai veprim. Shkencëtarët, përmes marrëveshjeve shtetërore dhe ndërkombëtare, kanë të drejtë dhe përgjegjësi që t’i vendosin kufijtë e hulumtimit shkencor.
5. Klonimi njeriut i paraqet karakteristikat kryesore të kapitalizmin. Edhe klonimi terapeutik edhe klonimi reprodutiv i shndërrojnë embrionet e njeriut në diçka më shumë se pjesë rezerve ose tesha për ata që mund t’ia lejojnë vetes. Kur qeniet njerëzore trajtohen si komoditet i tregut, atyre u mohohen të drejtat elementare si njerëz.